



Pranuar / Doretuar Punëno/Prodato Received/Delivered	31-03-2023	3	viti god Year
Organ /Mjesia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTEK	3233/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.473/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.473/2023 të datës 08.03.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi _____ i përfaqësuar me autorizim nga Av. _____ adresë _____

_____ kundër organit të punësimit/ Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.473/2023 e datës 08.03.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ i punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës/ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 08.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2480/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në kërkesë të datës 20.02.2023 me nr.181 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës/MFPT lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga shtat pikë pesë (7.5) në tetë (8) nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara nga institucionet e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.03.2023 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërsa Këshilli, me datë 16.03.2023 përmes emailit ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2732/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2480/2023 të datës 08.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigje e datës 20.02.2023 për kompensimin në mënyrë retroaktive për pjesën e humbur të pagës; Akt emërimi i datës 18.12.2018; Autorizimi për shërbime ligjore; Kërkesë e datës 03.02.2023 për kompensimin në mënyrë retroaktive për pjesën e humbur të pagës; Vendimi i datës 22.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë për pagesë retroaktive e datës 10.01.2023; Formular i të dhënave për listën e pagave i datës 10.01.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës „Udhëheqës i Zyrës së Punësimit, Vushtrri“ në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. I njëjti më datë 21.11.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë (8), ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1030/2022 të datës 22.12.2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë (8).

Ankuesi më datë 03.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës/MFPT për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit prej zero pikë pesë (0.5) të pagës në vlerë prej 33 euro të pagës mujore për pesë vite dhe atë nga muaji janari i vitit 2018. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës/MFPT përmes përgjigjes së datës 20.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 03.02.2023 me arsyetimin se Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës ka pranuar Vendimin e Këshillit për harmonizim të koeficientit të pagës dhe se me asnjërin pikë nga katër pikat e dispozitivit të Vendimit të Këshillit nuk kërkohet pagesa retroaktive e pagës nga ana e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 20.02.2023 të organit të punësimit, ankuesi me datë 08.03.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive konkretisht diferencën e koeficientit prej zero pikë pesë (0.5) të pagës në vlerë prej 33 euro të pagës mujore për pesë vite dhe atë nga muaji janari i vitit 2018.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 18.12.2018 ka nënshkruar pa vërejtje Aktin e Emërimit për pozitën e punës „Udhëheqës i Zyrës së Punësimit, Vushtrri “ me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), dhe se i njëjti deri me datë

03.02.2023 nuk ka ndërmarrë asnjë veprim administrativë me qëllim që të rregulloj çështjen që është objekt i këtij kontesti, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohej se: „Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”.

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen e realizimit të retroaktivit sa i përket koeficientit të pagës, thekson edhe faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 dhe si rrjedhojë i njëjti ka hy në fuqi nga data 05.02.2023, për më tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil mbi të cilin e bazon edhe pretendimin e ankuesit në objektin e kësaj ankese ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar se gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Bazuar në at që u tha më lartë dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.473/2023,

Vjollca SINANI

V. Sinani
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsorë GASHI-BAJRAKTARI

M. Gashi-Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim Av
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës/MFPT
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës/MFPT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së